

VENDIM
Nr. 437, datë 8.4.2008

PËR ANËTARËSIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË DEKLARATËN “DEKADA E ROMËVE”

(Ndryshuar me VKM nr. 445, datë 16.6.2011)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7 e 17 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme dhe të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Anëtarësimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë në deklaratën “Dekada e romëve”.

2. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, brenda një jave nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të përgatisë planin kombëtar të veprimit, për zbatimin e deklaratës “Dekada e romëve”.

3. Ngarkohet sektori i monitorimit të zbatimit të strategjisë kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom”, pranë Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, për monitorimin e planit kombëtar të veprimit, për zbatimin e deklaratës “Dekada e romëve”.

4. *Kontributi fillestar prej 20 000 (njëzet mijë) eurosh, që është vetëm për anëtarësimin në këtë nismë, si edhe shumat e kontributit për secilin vit pasues, që do të vendosen nga Komiteti Drejtues i “Dekadës së përfshirjes së romëve”, për vitin 2012 e në vijim, të përballohen nga fondet e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.*

5. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme të verë në dijeni, në rrugë diplomatike, presidencën hungareze, për anëtarësimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë në deklaratën “Dekada e romëve”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha